



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 122/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.03.2019 shqyrtoi ankesën me: _____

Objekt:

Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur – Marrëveshje Kuadër”, me objekt, “Për shërbimin e lavanderisë dhe hotelerisë në pavionet e S.U.O.GJ “Mbretëresha Geraldinë”, me nr. REF-91166-10-23-2018, me fond limit 163,019,950 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 20.11.2018, nga autoriteti kontraktor, S.U.O.GJ “Mbretëresha Geraldinë”.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Sanitary Cleaning” sh.p.k.
Adresa: Rr. “Teodor Keko”, P. Pelivani, Unaza e Re, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

S.U.O.GJ “Mbretëresha Geraldinë”
Adresa: Blv. Zog i I-rë, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

Public Health Sector II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 24.10.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur – Marrëveshje Kuadër”, me objekt, “Për shërbimin e lavanderisë dhe hotelerisë në pavionet e S.U.O.GJ “Mbretëresha Geraldinë””, me nr. REF-91166-10-23-2018, me fond limit 163,019,950 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 20.11.2018, nga autoriteti kontraktor, S.U.O.GJ “Mbretëresha Geraldinë”.

II.2. Në datën 30.10.2018, operatori ekonomik ankimues “Sanitary Cleaning” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e kritereve të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.3. Referuar dokumentacionit të administruar pranë KPP, në funksion të hetimit administrativ për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesën dhe i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues nëpërmjet shkresës nr. 1194/1 prot., datë 01.11.2018, duke e pranuar pjesërisht atë.

II.4. Në datën 09.11.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.5. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së sipërcituar, në datën 10.01.2019 Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin KPP 864/2018 datë 20.12.2018 ku vendosi:

1. *“Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Sanitary Cleaning” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur – Marrëveshje Kuadër”, me objekt, “Për shërbimin e lavanderisë dhe hotelerisë në pavionet e S.U.O.GJ “Mbretëresha Geraldinë”, me nr. REF-91166-10-23-2018, me fond limit 163,019,950 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 20.11.2018, nga autoriteti kontraktor, S.U.O.GJ “Mbretëresha Geraldinë”.*
2. *Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Sanitary Cleaning” sh.p.k.*
5. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik”*

II.6. Në datën 24.01.2019, autoriteti kontraktor ka publikuar shtojcën mbi modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me përmbajtje si më poshtë vijon:

“[...]ISHIN

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kerkohet qe ofertuesi te paraqese vertetim nga Administrata Tatimore, per xhiron vjetore per vitet 2015, 2016, 2017 e cila duhet te kete nje vlere mesatare vjetore jo me te vogel se 40 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Kerkohet qe ofertuesi te paraqese, Liçense per ushtrimin e aktivitetit, leshuar nga autoriteti kompetent, (Qendra Kombetare e Liçensimit)

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Operatori ekonomik duhet te disponoje ambjentin ku ushtron veprimtarine e sherbimit te lavanderise:

- *Te vertetuar me dokumentacionin perkates te pronesise apo te marrjes me qira (afati ne rastet e marrjes me qira duhet te jete ne perputhje me afatin e kryerjes se sherbimit te lavanderise – objekt prokurimi)*

- Lavanderia duhet te jete brenda qytetit te Tiranes, kjo distance kerkohet per shkak te specifikes se sherbimit, urgjencave te paparashikuara ne Spital.
- Lavanderia duhet te kete minimumi 300 m² te siperfaqes se saj.
- Te shoqeruar me leje nga QKL, autorizim mjedisor per aktivitetin lavanderi leshuar nga autoriteti perkates.
- Te jete shoqeruar me akt-teknik per sa i takon masave mbrojtese ndaj zjarrit.

Kerkohet qe ofertuesi te paraqese, Vertetim për fuqinë mesatare punëtore të operatorit ekonomik per periudhen, Janar – Shtator 2018, jo me pak se 26 punonjes, e vertetuar kjo me:

- Vertetim nga dega e tatim taksave per numrin e punonjesve te siguruar te shoqeruar me liste pagesat (formularet E-sig 025 a) te konfirmuara nepermjet formes elektronike.

Kerkohet qe ofertuesi te paraqese, deklarate qe verteton se disponon personelin e nevojshem per realizimin e kesaj kontrate si me poshte:

Nr	Personeli	Kodi qe verteton pozicionin me formularet E-sig 025 a	Nr.punonjësve
1	Pergjegjes sherbimi	1112.28	2
2	Punetor lavanderi dhe sherbimi ne reparte	8154.14	11
3	Punonjese sherbimi	5162.04	10
4	Teknik /inxhinieri elektronike	3114.06	1
5	Shofer	8322.01	2
	TOTALI		26

Operatori ekonomik ofertues duhet te deklaroje qe disponon makineri per larje, tharje, hekurosje, paketimi, transporti dhe karrela shërbimi deri tek shtrati i pacientit, me kapacitet larjeje minimum 757/dite, te vertetuara me dokumenta (fatura blerje dhe/ose zhdoganimi te shoqeruara me foto) si me poshte vijon:

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Makineri Larese me kualitet te larte larjeje dhe dizinfektimi me disa dhoma larje te cilat duhet te jene te lidhura me system dozimi i cili permbush pastrimin dhe higjenizimin e te gjithë bazes materiale si dhe karrocave qe shperndajne bazen materiale	Cope	1
2	Makineri Larëse Profesionale mbi 50 kg	Cope	7
3	Makineri larese me dy porta (barrier profesionale me kapacitet lares mbi 50	Cope	1

	kg		
4	Makineri Hekurosëse (Rul) Profesionale	Cope	3
5	Makineri tharëse profesionale me kapacitet thares mbi 50 kg	Cope	6
6	Makineri Paketimi Profesionale për paketim rrobash	Cope	1
7	Kosha metalik (karrela per mbatje rrobash)	Cope	10
8	Karroca stacioni (karrela sherbimi ne pavion per rrobat)	Cope	10
9	Peshore elektronike mbi 100 kg	Cope	1

Keto makineri duhet te jene te instaluara ne ambjentet e Lavanderise te cilat verifikohen nga KVO pas hapjes se ofertave

BEHEN

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kerkohet qe ofertuesi te paraqese vertetim nga Administrata Tatimore, per xhiron vjetore per vitet 2015, 2016, 2017 e cila duhet te kete nje xhiro vjetore jo me te vogel se 40 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

hiqet

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Operatori ekonomik duhet te disponoje ambjentin ku ushtron veprimtarine e sherbimit te lavanderise:

- Te vertetuar me dokumentacionin perkates te pronesise apo te marrjes me qira (afati ne rastet e marrjes me qira duhet te jete ne perputhje me afatin e kryerjes se sherbimit te lavanderise – objekt prokurimi)
- Lavanderia duhet te jete brenda rrethit te Tiranes, kjo distance kerkohet per shkak te specifikes se sherbimit, urgjencave te paparashikuara ne Spital.
- Lavanderia duhet te kete minimumi 280 m² te siperfaqes se saj.
- Te shoqeruar me leje nga QKL, Autorizim mjedisor per lavanteri me Kod III.1.A ose Leje Mjedisore e tipit “C” per aktivitetin pastrim kimik me Kod III.1.A, leje mjedisore me Kod III.1.A leshuar nga autoriteti perkates.
- Te jete shoqeruar me akt-teknik per sa i takon masave mbrojtese ndaj zjarrit.

Kerkohet qe ofertuesi te paraqese, Vertetim për fuqinë mesatare punetore te operatorit ekonomik per periudhen, Janar – Dhjetor 2018, jo me pak se 25 punonjes, e vertetuar kjo me:

- Vertetim nga dega e tatim taksave per numrin e punonjesve te siguruar te shoqeruar me liste pagesat (formularet E-sig 025 a) te konfirmuara nepermjet formes elektronike.

Kerkohet qe ofertuesi te paraqese, deklarate qe verteton se disponon personelin e nevojshem per realizimin e kesaj kontrate si me poshte:

Nr	Personeli	Nr.punonjësve
1	<i>Pergjegjes sherbimi</i>	2
2	<i>Punetor lavanderi dhe sherbimi ne reparte</i>	10
3	<i>Punonjese sherbimi</i>	10
4	<i>Teknik ose inxhinier elektronik/elektromekanik/mekanik/(te shoqeruar me diplomen perkatese)</i>	1
5	<i>Shofer</i>	2
	TOTALI	25

Operatori ekonomik ofertues duhet te deklaroje qe disponon makineri per larje, tharje, hekurosje, paketimi, transporti dhe karrela shërbimi deri tek shtrati i pacientit, me kapacitet larjeje minimum 757/dite, te vertetuara me dokumenta (fatura blerje dhe/ose zhdoganimi te shoqeruara me foto) si me poshte vijon:

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	<i>Makineri Larese me kualitet te larte larjeje me disa dhoma larje te cilat duhet te jene te lidhura me system dozimi i cili permbush pastrimin e te gjithë bazes materiale</i>	Cope	1
2	<i>Makineri per dezinfektimin e karrocave dhe koshave metalike me sistem dozimi</i>	Cope	1
3	<i>Makineri Larëse jo me te vogel se 50 kg</i>	Cope	6
4	<i>Makineri larese me dy porta (barrier profesionale me kapacitet lares jo me te vogel se 50 kg</i>	Cope	1
5	<i>Makineri Hekurosëse (Rul) Profesionale</i>	Cope	2
6	<i>Makineri tharëse profesionale me kapacitet thares jo me te vogel se 50 kg</i>	Cope	5
7	<i>Makineri Paketimi Profesionale për paketim rrobash</i>	Cope	1
8	<i>Kosha metalik (karrela per mbatje rrobash)</i>	Cope	10
9	<i>Karroca stacioni (karrela sherbimi ne pavion per rrobat)</i>	Cope	10

10	Peshore elektronike mbi 100 kg	Cope	1
----	--------------------------------	------	---

Keto makineri duhet te jene te instaluara ne ambjentet e Lavanderise te cilat verifikohen nga KVO pas hapjes se ofertave

V.O: Si rrjedhoje, afati i pranimit dhe hapjes se ofertave do te shtyhet me (5 pese) dite kalendarike, nga momenti i heqjes se pezullimit te procedures me Vendim te KPP-se. [...]"

II.7.Në datën 29.01.2019, operatori ekonomik ankimues “Sanitary Cleaning” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar përsëri modifikimin e kriterëve të procedurës së mësipërme të prokurimit, të ndryshuara nga autoriteti kontraktor me anë të shtojës të sipërcituar.

II.8. Referuar dokumentacionit të administruar pranë KPP, në funksion të hetimit administrativ për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesën dhe i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues nëpërmjet shkresës nr. 176/2 prot., datë 31.01.2019, duke mos e pranuar atë.

II.9.Në datën 11.02.2019 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“[...]Nga shqyrtimi i kësaj Shtojcë të DT të datës 24.01.2019, konstatojmë se serish vendimmarrja e AK për modifikimin e DT është jo vetëm në kundërshtim me LPP dhe RRPP, por edhe me Vendimin 864/2018 të KPP.

Më konkretisht: 1. KPP në pikën III.2.5 të Vendimit 864/2018, në kushtet kur ende data e hapjes ishte brenda vitit 2018, ka arsyetuar se për sa kohë ende nuk është mbyllur viti financiar 2018, vlera e xhiros për këtë vit nuk mund të përfshihej. Por, në kushtet kur tashmë jemi në fund të Janarit 2019, dhe viti 2018 konsiderohet tashmë si një vit i plotë financiar i mbyllur më 31.12.2018, nuk ka asnjë arsye që xhiroja e vitit 2018 të mos përfshihet. Për këtë arsye, vlerësojmë se AK duhet ta reflektojë edhe këtë fakt në ndryshimet e bëra me shtojcën e datës 24.01.2019. 2. KPP në pikën III.3.4 të Vendimit 864/2018, ka arsyetuar se përcaktimi i vendndodhjes së lavanderisë brenda qytetit të Tiranës është një kriter "diskriminues, i egzagjeruar dhe jo në përputhje me natyrën e përmasat e kontratës...". Pavarësisht nga kjo, AK, nuk e ka modifikuar këtë kriter dhe vazhdon të kërkojë edhe në Shtojcën e DT të datës 24.01.2019, që lavanderia të jetë brenda rrethit të Tiranës. Për këtë arsye, vlerësojmë se AK duhet ta reflektojë edhe këtë fakt në ndryshimet e bëra me shtojcën e datës 24.01.2019. 3. KPP në pikën III.3.5 të Vendimit 864/2018, ka arsyetuar se "përcaktimi i autoritetit kontraktor se minimumi i sipërfaqes të ambientit duhet të jetë 300 m, është një kërkesë e ekzagjeruar e cila nuk është në përpjestim me volumin e parashikuar të shërbimit objekt kontrate... ". Pra, KPP ka pranuar arsyetimin tonë se volumet e kërkuara të kontratës prej rreth 750 kg/ditë, nuk justifikojnë kërkesën për sipërfaqe minimale prej 300 m2, pasi edhe sikur të aplikohen distancat maksimale të montimit, përsëri mund të thuhet me siguri maksimale se një lavanderi mund të realizojë dhe deri në 2000 kg në ditë, edhe në një sipërfaqe jo më të madhe se 90-100 m2. Pavarësisht nga kjo, AK, nuk e ka modifikuar këtë kriter sipas arsyetimit të KPP, por në

Shtojcën e DT të datës 24.01.2019, e ka ulur sipërfaqen minimale të kërkuar nga 300 m² në vetëm 280 m², që në thelb nuk reflekton arsyetimin e KPP, por thjesht bën një ulje simbolike të sipërfaqes. Për këtë arsye, vlerësojmë së AK duhet ta reflektojë seriozisht dhe thelbësisht edhe këtë fakt në ndryshimet e bëra me shtojcën e datës 24.01.2019. 4. KPP në pikën III.4.5 të Vendimit 864/2018, ka përcaktuar se "...autoriteti kontraktor duhet të ulë numrin e punonjësve në përputhje me volumin e punës që do të kryhet për zbatimin e kontratës objekt prokurimi. ", duke pranuar arsyetimin tonë se: "...Numri i kërkuar prej 26 punonjësish është i ekzagjeruar dhe jo proporcional me kërkesat sasiore të kontratës që prokumhet. Vlen të sjellim në vëmendje të Autoriteti Kontraktor, se në procedurën e vitit 2016 të zhvilluar po nga "SUQU Mbretëresha Geraldinë", me të njëjtin objekt kontrate dhe me të njëjtën sasi teshash (552 610 kg) ka kërkuar gjithsej 17 punonjës, pra 9 më pak, ndërkohë aktualisht kërkohen 30% më shumë. ". Pavarësisht nga kjo, AK, nuk e ka modifikuar këtë kriter sipas arsyetimit të KPP, por në Shtojcën e DT të datës 24.01.2019, e ka ulur numrin e punonjësve të kërkuar nga 26 në 25 të tillë, që në thelb nuk reflekton arsyetimin e KPP, por thjesht bën një ulje simbolike të numrit me vetëm 1 punonjës. Për këtë arsye, vlerësojmë së AK duhet ta reflektojë seriozisht dhe thelbësisht edhe këtë fakt në ndryshimet e bëra me shtojcën e datës 24.01.2019. 5. KPP në pikën III.5.4 të Vendimit 864/2018, në lidhje me ankimin tonë për makineritë e kërkuara në pikën 7 të pikës "Kapaciteti teknik dhe profesional" ka përcaktuar se "...autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin duke ripërllogaritur numrin e makinerive të nevojshme për zbatimin e kontratës në përputhje me volumet e kësaj të fundit". Pavarësisht nga kjo, AK, nuk e ka modifikuar këtë kriter sipas arsyetimit të KPP, por në Shtojcën e DT të datës 24.01.2019, ka bërë modifikime të tilla të makinerive të kërkuara, që në thelb nuk reflekton arsyetimin e KPP, por thjesht bën një ulje simbolike të tyre si vijon:

Sqarojmë edhe një herë se në tërësinë e vet lista e makinerive të kërkuara është përsëri e ekzagjeruar, pasi rezulton se pas ndryshimeve: a. AK, me ane të Shtojcës së dt.24.01.2019, ka ndryshuar kriterin që ishte në pikën 1 të tabelës së makinerive, duke u shtuar kriteri nga një makineri e kërkuar, në dy makineri të kërkuara, ku makineria e shtuar, e kërkuar në pikën 1 të tabelës së modifikuar realizon funksionin e larjes. Nga ana tjetër, të njëjtin funksion, pra atë të larjes, e realizojnë edhe makineritë e kërkuara në pikë 3 të tabelës së modifikuar. Pra, pas modifikimeve, rezulton që vetëm për procesin e larjes të kërkohet në pikën (1) një linjë teknologjike larëse që kapacitetin minimal si rregull e ka 300 kg/orë dhe në pikën (3) janë kërkuar 6 copë Makineri Larëse jo me te vogël se 50 kg. Në këtë mënyrë, duke bërë këtë lloj modifikimi/shtese, AK ka dubluar makineritë e kërkuara për procesin e larjes. Sqarojmë se ndërkohë që sasia totale në ditë parashikohet vetëm 757 kg, duke pasur parasysh që një cikël larës nuk është më i gjatë se 1-1.5 orë, dhe që mund të realizohen minimalisht 4 cikle në ditë, rezulton që AK kërkon një kapacitet larës që rezulton minimalisht: a. Makineria e pikës (1): $300 \text{ kg/cikël} \times 4 \text{ cikle/ditë} = 1.200 \text{ kg/ditë}$ b. Makineritë e pikës (3): $6 \text{ makineri} \times 50 \text{ kg/cikel} \times 4 \text{ cikle/ditë} = 1.200 \text{ kg/ditë}$. $a + b = 2.400 \text{ kg/ditë}$ është minimumi i kapacitetit që realizojnë së bashku makineritë e kërkuara nga AK në pikat (1) dhe (3), ndërkohë që volumi i kërkuar nga AK është vetëm 757 kg/ditë, pra volum që mund të realizohet me 30 % të kapacitetit të kërkuar në pikat (1) dhe (3). Për arsyet e mësipërme vlerësojmë se për sa kohë janë kërkuar 6 makineri larëse me kapacitet jo më të vogël se 50 kg, këto janë më se të mjaftueshme ndaj nuk ka asnjë

arsye pse të qëndrojë kërkesa për makinerinë në pikën 1 të tabelës. b. Në pikën (5) dhe (6) numri i makinerive të kërkuara respektivisht për proceset e hekurosjes dhe tharjes është zvogëluar vetëm me nga 1 makineri pra ishte 3 makineri hekurosëse dhe është bërë 2 makineri dhe ishte 6 makineri tharëse dhe është bërë 5 të tilla. c. KPP ka orientuar AK që në tërësi të bëjë një ripërlllogaritje të numrit të makinerive të nevojshme për zbatimin e kontratës në përputhje me volumet e kësaj të fundit, por kjo nuk është bërë nga AK, pasi përvec sa u sqarua në pikat (a) e (b) më sipër në lidhje me numrin e ekzagjeruar të makinerive të kërkuara, edhe përcaktimi i kapacitetit "jo me te vogël se 50 kg" në pikën (3), (4) dhe (6) të tabelës është kufizues dhe sërish diskriminues, pasi për AK, e rëndësishme është që të realizohet përpunimi i volumit prej rreth 750 kg/ditë, volum i cili mund të realizohet me makineri të kapaciteteve të ndryshme, të kombinuara në mënyra të ndryshme, që mund të jenë p.sh për procesin e larjes si më poshtë: 10 makineri 35 kg x 3 cikle/ditë = 1.050 kg/ditë; ose (4 makineri 35 kg + 3 makineri 50 kg + 1 makineri 75 kg) x 3 cikle/ditë = 1095 kg/ditë.....e të tjera kombinime. AK nuk duhet të kufizojë konkurrencën duke rritur në mënyrë artificiale numrin e makinerive dhe duke përcaktuar në mënyrë detyruese kapacitetin për një makineri. Pra, në tërësinë e vet këto kërkesa nuk janë proporcionale dhe të arsyeshme në raport me sasinë e teshave spitalore që parashikohet të lahen. Gjithashtu, edhe këtu vlen të sjellim në vëmendje tuaj, se në procedurën e vitit 2016 për të njëjtin objekt kontrate dhe me të njëjtën sasi teshash (552 610 kg) kërkesat për makineri kanë qenë si vijon, duke parashikuar të përshtatshëm një kapacitet larës prej rreth 200 kg/cikël, ose 800 kg/ditë në ditë: Në dijeninë tonë, nuk rezultojnë kontrata e lidhur në vitin 2016 të mos jetë realizuar, apo të jetë raportuar ndonjë mospërmbyshje e kontratës për shkak të numrit të pamjaftueshëm të makinerive në vitin 2016. Për arsyet e dhëna në pikat (b) e (c) më sipër vlerësojmë se AK duhet ta reflektojë seriozisht dhe thelbësisht edhe këtë fakt në ndryshimet e bëra me shtojcën e datës 24.01.2019. 6. AK, në fund të Shtojcës së datës 24.01.2019, shprehet se: "Si rrjedhojë, afati i pranimit dhe hapjes së ofertave do të shtyhet me (5 pese) dite kalendarike, nga momenti i heqjes së pezullimit të procedurës me Vendim të KPP-se" Ky përcaktim i AK është në kundërshtim me nenin 63 të LPP dhe nenin 78 pika 6 (d) të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". AK nuk mund të vendosë që ta shtyjë afatin e pranimit me vetëm 5 ditë kalendarike nga momenti i heqjes së pezullimit nga KPP. Sjellim në vëmendjen tuaj se shtyrja e datës së dorëzimit të ofertave nuk ka ardhur si rredhë e publikimit të një shtojce për shkak të kërkesës për sqarime sipas nenit 42 të LPP, por sepse procedura e prokurimit ka qenë e pezulluar që nga data 05.11.2018 për shkak të ankesës së shoqërisë tonë bazuar në nenin 63 pika 1.1. të LPP dhe më pas në vijim të vendimit të KPP. Ndryshe nga rastet e parashikimit të nenit 42 të LPP, ku edhe autoriteti kontraktor duket se është mbështetur, që lidhet me modifikimin e dokumentave të procedurës së prokurimit pas kërkesës për sqarime, me vetë iniciativën e autoritetit kontraktor (pra kur procedura s'ka qenë më parë e pezulluar), kur procedura ka qenë e pezulluar për shkak ankimi, atëherë do të thirren në zbatim parashikimet e nenit 78 të VKM 914, datë 29.12.2014. Sa më sipër sqaruar, konstatojmë se procedura e prokurimit ka qenë e pezulluar për 84 ditë dhe për rrjedhojë bazuar në parashikimet e nenit 78 pika 6 duhet të shtyhet për 84 ditë. Gjithsesi, duke qenë një kohë kaq e gjatë, minimalisht autoriteti kontraktor duhet të shtyjë procedurën e prokurimit për aq ditë sa është afati kohor i përcaktuar nga neni 43 i LPP dhe neni 33 pika 4 i VKM 914, datë 29.12.2014. Pra në rastin

konkret afati minimal për marrjen e ofertave është 24 ditë që procedura duhet të qëndrojë e publikuar, aktive dhe jo e pezulluar. Procedura e prokurimit është publikuar në datë 24.10.2018 dhe është pezulluar në datë 01.11.2018 duke qëndruar vetëm 6 ditë e publikuar aktive, ndërkohë që ende nuk është hequr nga pezullimi, ndaj AK duhet të sigurojë minimumi edhe 18 ditë të tjera nga heqja e pezullimit që procedura të jetë aktive. Pra edhe në këtë rast, me shtyrjen vetëm 5 ditë autoriteti kontraktor sërish ka cënuar edhe minimumin ligjor të lejuar për publikimin e procedurës së prokurimit.[...]

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin: “[...]1. KPP në pikën III.2.5 të Vendimit 864/2018, në kushtet kur ende data e hapjes ishte brenda vitit 2018, ka arsyetuar se për sa kohë ende nuk është mbyllur viti financiar 2018, vlera e xhiros për këtë vit nuk mund të përfshihej. Por, në kushtet kur tashmë jemi në fund të Janarit 2019, dhe viti 2018 konsiderohet tashmë si një vit i plotë financiar i mbyllur më 31.12.2018, nuk ka asnjë arsye që xhironja e vitit 2018 të mos përfshihet. Për këtë arsye, vlerësojmë së AK duhet ta reflektojë edhe këtë fakt në ndryshimet e bëra me shtojcën e datës 24.01.2019[...]

III.1.1.Në shtojcën nr.1 datë 24.01.2019, mbi modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kryer ndryshimin si më poshtë vijon:

“Ishte

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kerkohet qe ofertuesi te paraqese vertetim nga Administrata Tatimore, per xhiron vjetore per vitet 2015, 2016, 2017 e cila duhet te kete nje vlere mesatare vjetore jo me te vogel se 40 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.”

Bëhet

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kerkohet qe ofertuesi te paraqese vertetim nga Administrata Tatimore, per xhiron vjetore per vitet 2015, 2016, 2017 e cila duhet te kete nje xhiro vjetore jo me te vogel se 40 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

III.1.2. Në nenin 46, pika 1 gërma c, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “ [...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e

prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese; c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur; [...]”

III.1.3. Në nenin 28 pika 4/b të VKM Nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik” i ndryshuar parashikohet se: “4. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: b)“kopje të deklaratave të xhiros vjetore. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet. Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet; dhe/ose””

III.1.4. Neni 1 i LPP parashikon shprehimish se: “Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik si dhe dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

III.1.5. Nga shqyrtimi i shtojcës mbi modifikimin e dokumentave të tenderit, vërehet se, autoriteti kontraktor ka kërkuar vërtetim nga Administrata Tatimore, për xhiron vjetore për vitet 2015, 2016, 2017 e cila duhet të ketë një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet. Referuar dispozitave ligjore të sipërcituara, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet ekonomike, besueshmërinë, dhe përvojën e duhur, në përputhje dhe në përpjestim me volumnin e kontratës objekt prokurimi, për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur. Lidhur, me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes, mbi periudhën financiare për të cilën duhet të paraqitet vërtetimi mbi xhiron vjetore, Komisioni gjykon se, referuar legjilacionit në fuqi për prokurimin publik, si dhe atij sektorial, vërtetimet mb xhiron vjetore, mund të kërkojnë për vite të plota financiare. Në këto kushte, për sa kohë viti financiar 2018 tashmë është mbyllur, bazuar në nenin 46, pika 1 gërma c, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor duhet të kërkojë vërtetim mbi xhiron vjetore, për 3 vitet e fundit financiar

(2016, 2017, 2018). Përsa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e mësipërm sipas konstatimeve të Komisionit

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: “2. KPP në pikën III.3.4 të Vendimit 864/2018, ka arsyetuar se përcaktimi i vendndodhjes së lavanderisë brenda qytetit të Tiranës është një kriter "diskriminues, i egzagjeruar dhe jo në përputhje me natyrën e përmasat e kontratës...". Pavarësisht nga kjo, AK, nuk e ka modifikuar këtë kriter dhe vazhdon të kërkojë edhe në Shtojcën e DT të datës 24.01.2019, që lavanderia të jetë brenda rrethit të Tiranës. Për këtë arsye, vlerësojmë se AK duhet ta reflektojë edhe këtë fakt në ndryshimet e bëra me shtojcën e datës 24.01.2019. 3. KPP në pikën III.3.5 të Vendimit 864/2018, ka arsyetuar se "përcaktimi i autoritetit kontraktor se minimumi i sipërfaqes të ambientit duhet të jetë 300 m, është një kërkesë e egzagjeruar e cila nuk është në përpjestim me volumin e parashikuar të shërbimit objekt kontrate... ". Pra, KPP ka pranuar arsyetimin tonë se volumet e kërkuara të kontratës prej rreth 750 kg/ditë, nuk justifikojnë kërkesën për sipërfaqe minimale prej 300 m2, pasi edhe edhe sikur të aplikohen distancat maksimale të montimit, përsëri mund të thuhet me siguri maksimale se një lavanderi mund të realizojë dhe deri në 2000 kg në ditë, edhe në një sipërfaqe jo më të madhe se 90-100 m2. Pavarësisht nga kjo, AK, nuk e ka modifikuar këtë kriter sipas arsyetimit të KPP, por në Shtojcën e DT të datës 24.01.2019, e ka ulur sipërfaqen minimale të kërkuar nga 300 m2 në vetëm 280 m2, që në thelb nuk reflekton arsyetimin e KPP, por thjesht bën një ulje simbolike të sipërfaqes. Për këtë arsye, vlerësojmë se AK duhet ta reflektojë seriozisht dhe thelbësisht edhe këtë fakt në ndryshimet e bëra me shtojcën e datës 24.01.2019. 4. KPP në pikën III.4.5 të Vendimit 864/2018, ka përcaktuar se "...autoriteti kontraktor duhet të ulë numrin e punonjësve në përputhje me volumin e punës që do të kryhet për zbatimin e kontratës objekt prokurimi. ", duke pranuar arsyetimin tonë se: "...Numri i kërkuar prej 26 punonjësish është i egzagjeruar dhe jo proporcional me kërkesat sasiore të kontratës që prokumhet. Vlen të sjellim në vëmendje të Autoriteti Kontraktor, se në procedurën e vitit 2016 të zhvilluar po nga "SUQU Mbretëresha Geraldinë", me të njëjtin objekt kontrate dhe me të njëjtën sasi teshash (552 610 kg) ka kërkuar gjithsej 17 punonjës, pra 9 më pak, ndërkohë aktualisht kërkohej 30% më shumë. ". Pavarësisht nga kjo, AK, nuk e ka modifikuar këtë kriter sipas arsyetimit të KPP, por në Shtojcën e DT të datës 24.01.2019, e ka ulur numrin e punonjësve të kërkuar nga 26 në 25 të tillë, që në thelb nuk reflekton arsyetimin e KPP, por thjesht bën një ulje simbolike të numrit me vetëm 1 punonjës. Për këtë arsye, vlerësojmë se AK duhet ta reflektojë seriozisht dhe thelbësisht edhe këtë fakt në ndryshimet e bëra me shtojcën e datës 24.01.2019. 5. KPP në pikën III.5.4 të Vendimit 864/2018, në lidhje me ankimin tonë për makineritë e kërkuam në pikën 7 të pikës "Kapaciteti teknik dhe profesional" ka përcaktuar se "...autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin duke ripërllogaritur numrin e makinerive të nevojshme për zbatimin e kontratës në përputhje me volumet e kësaj të fundit". Pavarësisht nga kjo, AK, nuk e ka modifikuar këtë kriter sipas arsyetimit të KPP, por në Shtojcën e DT të datës 24.01.2019, ka bërë modifikime të tilla të

makinerive të kërkuara, që në thelb nuk reflekton arsyetimin e KPP, por thjesht bën një ulje simbolike të tyre” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1.Në shtojcën nr.1 datë 24.01.2019, mbi modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kryer ndryshimin si më poshtë vijon:

“Ishin

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Operatori ekonomik duhet të disponojë ambjentin ku ushtron veprimtarinë e shërbimit të lavanderisë:

- Te vertetuar me dokumentacionin perkates te pronesise apo te marrjes me qira (afati ne rastet e marrjes me qira duhet te jete ne perputhje me afatin e kryerjes se shërbimit të lavanderisë – objekt prokurimi)
- Lavanderia duhet të jete brenda qytetit të Tiranës, kjo distance kerkohet për shkak të specifikës së shërbimit, urgjencave të paparashikuara në Spital.
- Lavanderia duhet të ketë minimumi 300 m² të sipërfaqes së saj.
- Te shoqëruar me leje nga QKL, autorizim mjedisor për aktivitetin lavanderi leshuar nga autoriteti perkates.
- Te jete shoqëruar me akt-teknik për sa i takon masave mbrojtëse ndaj zjarrit.

Kerkohet që ofertuesi të paraqesë, Vertetim për fuqinë mesatare punëtore të operatorit ekonomik për periudhën, Janar – Shtator 2018, jo më pak se 26 punonjës, e vertetuar kjo me:

- Vertetim nga dega e tatim taksave për numrin e punonjësve të siguruar të shoqëruar me liste pagesat (formularët E-sig 025 a) të konfirmuara nepermjet formes elektronike.

Kerkohet që ofertuesi të paraqesë, deklarate që verteton se disponon personelin e nevojshëm për realizimin e kësaj kontrate si më poshtë:

Nr	Personeli	Kodi që verteton pozicionin me formularët E-sig 025 a	Nr.punonjësve
1	Përgjegjës shërbimi	1112.28	2
2	Punëtor lavanderi dhe shërbimi në repart	8154.14	11
3	Punonjës shërbimi	5162.04	10
4	Teknik /inxhinieri elektronike	3114.06	1
5	Shofer	8322.01	2
	TOTALI		26

Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë që disponon makineri për larje, tharje, hekurosje, paketimi, transporti dhe karrela shërbimi deri tek shtrati i pacientit, me kapacitet larjeje minimum 757/dite, të vertetuara me dokumenta (fatura blerje dhe/ose zhdoganimi të shoqëruara me foto) si më poshtë vijon:

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Makineri Larese me kualitet te larte larjeje dhe dizinfektimi me disa dhoma larje te cilat duhet te jene te lidhura me system dozimi i cili permbush pastrimin dhe higjenizimin e te gjithë bazes materiale si dhe karrocave qe shperndajne bazen materiale	Cope	1
2	Makineri Larëse Profesionale mbi 50 kg	Cope	7
3	Makineri larese me dy porta (barrier profesionale me kapacitet lares mbi 50 kg	Cope	1
4	Makineri Hekurosëse (Rul) Profesionale	Cope	3
5	Makineri tharëse profesionale me kapacitet thares mbi 50 kg	Cope	6
6	Makineri Paketimi Profesionale për paketim rrobash	Cope	1
7	Kosha metalik (karrela per mbatje rrobash)	Cope	10
8	Karroca stacioni (karrela sherbimi ne pavion per rrobat)	Cope	10
9	Peshore elektronike mbi 100 kg	Cope	1

Keto makineri duhet te jene te instaluar ne ambjentet e Lavanderise te cilat verifikohen nga KVO pas hapjes se ofertave”

Bëhen

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Operatori ekonomik duhet te disponoje ambjentin ku ushtron veprimtarine e sherbimit te lavanderise:

- Te vertetuar me dokumentacionin perkates te pronesise apo te marrjes me qira (afati ne rastet e marrjes me qira duhet te jete ne perputhje me afatin e kryerjes se sherbimit te lavanderise – objekt prokurimi)
- Lavanderia duhet te jete brenda rrethit te Tiranes, kjo distance kerkohet per shkak te specifikes se sherbimit, urgjencave te paparashikuara ne Spital.
- Lavanderia duhet te kete minimumi 280 m² te siperfaqes se saj.
- Te shoqeruar me leje nga QKL, Autorizim mjedisor per lavaneri me Kod III.1.A ose Leje Mjedisore e tipit “C” per aktivitetin pastrim kimik me Kod III.1.A, leje mjedisore me Kod III.1.A leshuar nga autoriteti perkates.

- Te jete shoqeruar me akt-teknik per sa i takon masave mbrojtese ndaj zjarrit.
Kerkohet qe ofertuesi te paraqese, Vertetim për fuqinë mesatare punetore te operatorit ekonomik per periudhen, Janar – Dhjetor 2018, jo me pak se 25 punonjes, e vertetuar kjo me:
- Vertetim nga dega e tatim taksave per numrin e punonjesve te siguruar te shoqeruar me liste pagesat (formularet E-sig 025 a) te konfirmuara nepermjet formes elektronike.
Kerkohet qe ofertuesi te paraqese, deklarate qe verteton se disponon personelin e nevojshem per realizimin e kesaj kontrate si me poshte:

Nr	Personeli	Nr.punonjësve
1	<i>Pergjegjes sherbimi</i>	2
2	<i>Punetor lavanderi dhe sherbimi ne reparte</i>	10
3	<i>Punonjese sherbimi</i>	10
4	<i>Teknik ose inxhinier elektronik/elektromekanik/mekanik/(te shoqeruar me diplomen perkatese)</i>	1
5	<i>Shofer</i>	2
	TOTALI	25

Operatori ekonomik ofertues duhet te deklaroje qe disponon makineri per larje, tharje, hekurosje, paketimi, transporti dhe karrela shërbimi deri tek shtrati i pacientit, me kapacitet larjeje minimum 757/dite, te vertetuara me dokumenta (fatura blerje dhe/ose zhdoganimi te shoqeruara me foto) si me poshte vijon:

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	<i>Makineri Larese me kualitet te larte larjeje me disa dhoma larje te cilat duhet te jene te lidhura me system dozimi i cili permbush pastrimin e te gjithë bazes materiale</i>	<i>Cope</i>	1
2	<i>Makineri per dezinfektimin e karrocave dhe koshave metalike me sistem dozimi</i>	<i>Cope</i>	1
3	<i>Makineri Larëse jo me te vogel se 50 kg</i>	<i>Cope</i>	6
4	<i>Makineri larese me dy porta (barrier profesionale me kapacitet lares jo me te vogel se 50 kg</i>	<i>Cope</i>	1
5	<i>Makineri Hekurosëse (Rul) Profesionale</i>	<i>Cope</i>	2
6	<i>Makineri tharëse profesionale me kapacitet thares jo me te vogel se 50</i>	<i>Cope</i>	5

	kg		
7	Makineri Paketimi Profesionale për paketim rrobash	Cope	1
8	Kosha metalik (karrela per mbatje rrobash)	Cope	10
9	Karroca stacioni (karrela sherbimi ne pavion per rrobat)	Cope	10
10	Peshore elektronike mbi 100 kg	Cope	1

Keto makineri duhet te jene te instaluara ne ambientet e Lavanderise te cilat verifikohen nga KVO pas hapjes se ofertave

III.2.2. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “ [...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]”

III.2.3. Në nenin 28, pika 5, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “5.Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a)licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b)një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla;dhe/ose

c)dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose

ç)dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”.

III.2.4. Lidhur me pretendimet e mësipërme të ankimuesit mbi kriteret e vecanta të kualifikimit, të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, këto pretendime lidhen me ndryshimet e kryera nga autoriteti kontraktor në zbatim të vendimit K.P.P 864/2018. Nga shqyrtimi i këtyre ndryshimeve, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer modifikimet duke i riformuluar këto kriteret në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e Komisionit të Prokurimit Publik në vendimin K.P.P 864/2018, duke e zbatuar këtë vendim. Komisioni vlerëson të theksojë se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet

dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetohet se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Përsa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, nuk mund rigjykojë në pafundësi të njëjtat pretendime dhe për të njëjtën çështje, deri në vendosjen e kriterëve sipas pretendimeve të ankimuesit.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: “[...]a. AK, me ane të Shtojcës së dt.24.01.2019, ka ndryshuar kriterin që ishte në pikën 1 të tabelës së makinerive, duke u shtuar kriteri nga një makineri e kërkuar, në dy makineri të kërkuara, ku makineria e shtuar, e kërkuar në pikën 1 të tabelës së modifikuar realizon funksionin e larjes. Nga ana tjetër, të njëjtin funksion, pra atë të larjes, e realizojnë edhe makineritë e kërkuara në pikë 3 të tabelës së modifikuar. Pra, pas modifikimeve, rezulton që vetëm për procesin e larjes të kërkohej në pikën (1) një linjë teknologjike larëse që kapacitetin minimal si rregull e ka 300 kg/orë dhe në pikën (3) janë kërkuar 6 copë Makineri Larëse jo me te vogël se 50 kg. Në këtë mënyrë, duke bërë këtë lloj modifikimi/shtese, AK ka dubluar makineritë e kërkuara për procesin e larjes. Sqarojmë se ndërkohë që sasia totale në ditë parashikohet vetëm 757 kg, duke pasur parasysh që një cikël larës nuk është më i gjatë se 1-1.5 orë, dhe që mund të realizohen minimalisht 4 cikle në ditë, rezulton që AK kërkon një kapacitet larës që rezulton minimalisht: a. Makineria e pikës (1): $300 \text{ kg/cikël} \times 4 \text{ cikle/ditë} = 1.200 \text{ kg/ditë}$ b. Makineritë e pikës (3): $6 \text{ makineri} \times 50 \text{ kg/cikel} \times 4 \text{ cikle/ditë} = 1.200 \text{ kg/ditë}$. $a + b = 2.400 \text{ kg/ditë}$ është minimumi i kapacitetit që realizojnë së bashku makineritë e kërkuara nga AK në pikat (1) dhe (3), ndërkohë që volumi i kërkuar nga AK është vetëm 757 kg/ditë, pra volum që mund të realizohet me 30 % të kapacitetit të kërkuar në pikat (1) dhe (3). Për arsyet e mësipërme vlerësojmë se për sa kohë janë kërkuar 6 makineri larëse me kapacitet jo më të vogël se 50 kg, këto janë më se të mjaftueshme ndaj nuk ka asnjë arsye pse të qëndrojë kërkesa për makinerinë në pikën 1 të tabelës[...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën nr.1 datë 24.01.2019, mbi modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kryer ndryshimin, duke shtuar një makineri si më poshtë vijon:

1	Makineri Larese me kualitet te larte larjeje me disa dhoma larje te cilat duhet te jene te lidhura me system dozimi i cili permbush pastrimin e te gjithë bazes materiale	Cope	1
---	---	------	---

III.3.2. Në nenin 28, pika 5, gërma “ç” të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “[...]Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën [...]”

III.3.3. Në lidhje me kërkimin e operatorit ekonomik ankimues, mbi makinerinë larëse me kualitet të lartë larjeje dhe dizinfektimi me disa dhoma larje të cilat duhet të jenë të lidhura me sistem dozimi i cili përmbush pastrimin dhe higjenizimin e të gjithë bazës materiale, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kjo makineri shërben për sterilizimin e bazës materiale dhe nuk kryen të njëjtin funksion me makineritë e kërkuara në pikën 3 të tabelës “Makineri Larëse jo më të vogël se 50 kg”, të cilat shërbejnë për larjen e materialeve tekstile objekt prokurimi. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për mbarëvajtjen e shërbimit, si dhe në zbatim të përcaktimeve të autoritetit kontraktor në grafikun e shërbimit dhe specifikimet teknike, në të cilën parashikohet të kryhet shërbimi i lavanderisë për 757 kg materiale të buta spitalore, për shtatë ditë javës, 24 orë në ditë, disponueshmëria e makinerisë sterilizimin e bazës materiale të është e domosdoshme, pasi kemi të bëjmë me materiale spitalore, ku steriliteti duhet të jetë absolutisht në nivelet maksimale, pavarësisht nëse këto materiale janë konstatuar si të infektuara apo jo. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në kto kushte, Komisioni gjykon se kërkesa për disponimin e një makinerie larëse me kualitet të lartë larjeje dhe dizinfektimi me disa dhoma larje të cilat duhet të jenë të lidhura me sistem dozimi i cili përmbush pastrimin dhe higjenizimin e të gjithë bazës materiale është në përputhje me volumin e kontratës dhe e lidhur ngushtë me objektin e prokurimit.

Public Health Sector

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi shtyrjen e afatit të dorëzimit të ofertave në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin se: “[...]AK nuk mund të vendosë që ta shtyjë afatin e pranimit me vetëm 5 ditë kalendarike nga momenti i heqjes së pezullimit nga KPP. Sjellim në vëmendjen tuaj se shtyrja e datës së dorëzimit të ofertave nuk ka ardhur si rredhojë e publikimit të një shtojce për shkak të kërkesës për sqarime sipas nenit 42 të LPP, por sepse procedura e prokurimit ka qenë e pezulluar që nga data 05.11.2018 për shkak të ankesës së shoqërisë tonë bazuar në nenin 63 pika 1.1. të LPP dhe më pas në vijim të vendimit të KPP.[...], Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën nr.1 datë 24.01.2019, mbi modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si vijon: “V.O: Si rrjedhojë, afati i pranimit dhe hapjes së ofertave do të shtyhet me (5 pese) dite kalendarike, nga momenti i heqjes së pezullimit të procedurës me Vendim të KPP-se.”

III.4.2. Në nenin 42, pika 2, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “2. Autoriteti kontraktor, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga një operator ekonomik, mund të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit, përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit dhe bëhet detyruese për ta. Shtojca vihet në dispozicion edhe në rrugë elektronike.

2/1. Në çdo rast, kur ndryshohen dokumentet e tenderit, autoriteti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me 5 ditë, ndërsa për prokurimet mbi kufijtë e lartë monetarë me 10 ditë.”

III.4.3. Në nenin 78, pika 6/d, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, nëse nevojitet, duhet të zgjatë afatin kohor të procedurës së prokurimit aq sa zgjat periudha e pezullimit. Në rastet kur afatet kohore të procedurës së prokurimit, për të cilat janë njoftuar ofertuesit, ndryshojnë për shkak të marrjes parasysh të ankesës, autoriteti kontraktor u shpërndan ofertuesve një njoftim të posaçëm, ku jepen arsyet për zgjatjen e këtyre afateve.”

III.4.4. Nga interpretimi literal i dispozitave të sipërcituara, Komisioni konstaton se në ligjin për prokurimin publik dhe në rregullat e prokurimit publik, janë parashikuar dy përcaktime lidhur me zgjatjen e afatit kohor të dorëzimit të ofertave. Në rastin e modifikimit të dokumentave të tenderit, ligjvënësi ka sanksionuar në mënyrë eksplicite se në çdo rast afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave shtyhet me 5 ditë, ndërsa nga ana tjetër, në rregullat e prokurimit publik, parashikohet në mënyrë kushtore se, « nëse nevojitet » autoriteti kontraktor mund të shtyjë afatin e procedurës së prokurimit për aq kohë sa zgjat periudha e pezullimit. Në rastin konkret, Komisioni thekson se procedura e prokurimit objekt shqyrtimi, qëndron ende e pezulluar me vendim të Komisioni të Prokurimit Publik Nr.1708/1Protokolli, dhe afati 5 ditor për pranimin e ofertave do të nisë nga dita e heqjes së pezullimit, po me vendim nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Lidhur me pretendimin e ankimuesit, Komisioni gjykon se ndryshimet e kryera në kriteret e kualifikimit nga ana e autoritetit kontraktor, në zbatim të vendimit të KPP, nuk i rëndojnë pozitat e operatorëve ekonomik të interesuar, përkundrazi, ato janë saktësuar apo thjeshtuar, duke mos shtuar kriteret të cilat do të kërkonin kohë të konsiderueshme për sigurimin e dokumentacionit provues nga ana e të interesuarve. Në këto kushte, Komisioni gjykon se nuk është e nevojshme një zgjatje e afatit të pranimi të ofertave për aq sa ka zgjatur pezullimi i procedurës, për këtë arsye, qëndrimi strikt ndaj parashikimit të nenit 42, pika 2/1, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, duke e shtyrë afatin me 5 ditë nga momenti i heqjes së pezullimit është më se i mjaftueshëm.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Sanitary Cleaning” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur – Marrëveshje Kuadër*”, me objekt, “*Për shërbimin e lavanderisë dhe hotelerisë në pavionet e S.U.O.GJ “Mbretëresha Geraldinë”*”, me nr. REF-91166-10-23-2018, me fond limit 163,019,950 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 20.11.2018, nga autoriteti kontraktor, S.U.O.GJ “Mbretëresha Geraldinë”.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Sanitary Cleaning” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 210 Protokoli, Datë 11.02.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha